

Qëndrimet e komunitetit serb në Kosovë rreth Bashkimit Evropian



Anketë
Hulumtim Sasior

Prill-Maj 2012

Qëndrimet
e komunitetit serb në Kosovë
rreth Bashkimit Evropian

Hulumtimi u koordinua dhe zbatua nga D&G Solution, Mitrovicë
Interpretimin e të dhënave e bëri Shkelzen Maliqi

Hulumtimi u realizua me përkrahje të
Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur

*Mendimet, qendrimet dhe konkludimet e shprehura në këtë punim nuk
paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e Fondacionit të Kosovës për
Shoqëri të Hapur.*



Qëndrimet e komunitetit serb në Kosovë rreth Bashkimit Evropian

Anketë
Hulumtim Sasior

Prill-Maj 2012

Përmbajtja

Përmbledhje e hulumtimit	7
Analizë e qëndrimeve	11
I. QËNDRIMET RRETH BASHKIMIT EVROPIAN	11
II. KOSOVA DHE BASHKIMI EVROPIAN	14
III. PËRCEPTIMI I PROBLEMIT TË KOSOVËS	17
IV. VLERËSIMI I PUNËS SË QEVERIVE DHE UDHËHEQËSVE	19
 Pasqyra grafike e rezultateve të anketës me shpjegime	 23
1. Burimet kryesore të informimit	23
2. Sa iu besoni medimeve në Kosovë?	25
3. A jeni mjaft të informuar për Bashkimin Evropian?	26
4. A e ndjeni veten qytetar të Evropës?	27
5. A e përkrahni anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian?	28
6. A mendoni se Kosova ka potencial të mjaftueshëm për t'u integruar në BE?	29
7. Kur do të anëtarësohet Kosova në Bashkimin Evropian?	30
8. A do të përfitoj Kosova nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian?	31
9. A duhet të ketë Bashkimi Evropian rol kyç në zgjidhjen e problemeve të komunitetit serb në Kosovë?	32
10. A janë kufijtë e hapur gjë e mirë për të gjithë qytetarët e Evropës?	34
11. Shkalla e informimit rreth procesit të anëtarësimit të Kosovës në BE	35
12. Problemi më i madh në Kosovë	36
13. Vlerësimi i marrëdhënieve në mes serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë	38
14. Vlerësimi i punës së qeverive lokale	39
15. Vlerësimi i punës së qeverisë qendrore	40
16. Qëndrimet rreth korrupsionit në Kosovë	42
17. Dhënia e ryshfetit	43
18. Gjërat në Kosovë po shkojnë në drejtim të duhur apo në drejtim të gabuar?	44
19. Vlerësimi i zhvillimit lokal evropian	45
20. A janë të mjaftueshme investimet e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë?	46
21. A janë të mjaftueshme investimet e bashkësisë ndërkombëtare në veri të Kosovës?	47
22. Kujt i besoni më tepër?	49
23. Si i vlerësoni qëndrimet e komunitetit serb në veri të lumit Ibër?	50
24. Si i vlerësoni qëndrimet e komunitetit serb në jug të lumit Ibër?	51
 Shtojca 1	 53
PYETËSORI	53
PYETJET E ANKETËS.....	55
 Shtojca 2	 60
LISTA E VENDEVE KU JANË ZHVILLUAR ANKETAT DHE NUMRI I ANKETAVE	60

Përmbledhje e hulumtimit

Studimi mbi “Qëndrimet e komunitetit serb në Kosovë rreth Bashkimit Evropian” u zhvillua gjatë periudhës prill-maj të vitit 2012.

Studimi kishte për qëllim mbledhjen e të dhënave relevante rreth qëndrimit të komunitetit serb në Kosovë ndaj Bashkimit Evropian, rreth perspektivës së Kosovës drejt anëtarësimit në BE, si dhe rreth disa çështjeve të tjera të cilat lidhen drejtpërdrejt dhe tërthorazi me komunitetin serb dhe të ardhmen evropiane të Kosovës. Qëndrimet e pasqyruara në këtë hulumtim sasior në mënyrë të drejtpërdrejt dhe tërthorazi ofrojnë pasqyrë relevante për nivelin e ndryshueshëm të integritetit të komunitetit serb në realitetin kosovar.

Hulumtimi është kryer mbi bazën e mostrës prej 750 respondentëve, në pesë rajone, apo komuna: në **Veri të Kosovës** (150), në **Graçanicë** (150), në **Ranillug** (150), në **Shtërpce** (150) dhe **Rahovec** (150). Mostra përmban material të mjaftueshëm sasior për analizimin e qëndrimeve dhe orientimeve të komunitetit serb në temën e integritimeve evropiane si dhe për disa çështje të tjera. Megjithatë, duhet mbajtur në mend që mostra e këtij hulumtimi bazohet në kuotat prej 150 anketave në çdo lokacion, dhe jo në mostrat përfaqësuese, në të cilin rast, në çdo vend në Kosovë ku banojnë pjesëtarë të komunitetit serb numri i anketave në çdo vendbanim do të duhej të përcaktohej në bazë të përqindjes së përfaqësimit të këtij komuniteti në popullsinë e Kosovës. Po të kishim ndjekur rastin e mostrës përfaqësuese, numri i anketave në Ranillug ose Rahovec, ku komuniteti serb është dukshëm më i vogël në krahasim me numrin e serbëve që jetojnë në Graçanicë ose në Veri të Kosovës, do të ishte rreth 20 sosh, dhe me këtë numër të anketave nuk mund të mbledhen të dhëna relevante për qëndrimet lokale të serbëve. Vendimi për kuotën

prej 150 anketave erdhi nga dëshira për të mbledhur të dhëna relevante në të gjitha pjesët e Kosovës ku u zhvillua anketimi, në mënyrë që pastaj të mund të krahasohen qëndrimet e komunitetit serb në Veri, me qëndrimet e po të njëjtit komunitet i cili jeton në jug të lumit Ibër, si dhe qëndrimet e serbëve në Graçanicë, Ranillug, Shtërpce dhe Rahovec. Për shkak të strukturës së mostrimit të bazuar në kuota të vetme, të dhënat e mbledhura për tërë hulumtimin, e të cilat tash e tutje në tekst do të njihen si *Mostra e përgjithshme e hulumtimit*, duhet të merren me rezervë të caktuar, më tepër si indikator për mesataren e qëndrimeve të respondentëve, dhe jo si ndarje reale e qëndrimeve dhe orientimeve e cila do të fitohej në rast se anketa do të zhvillohej mbi bazën e mostrës përfaqësuese.

Vlerat e mostrës së përdorur në këtë hulumtim japin rezultate dhe pasqyrë më të mirë mbi qëndrimet e pjesëtarëve të komunitetit serb kur krahasohen të dhënat në bazë të regjioneve apo komunave, sepse procesi i anketimit në këtë nivel u zhvillua sipas standardeve të mostrës përfaqësuese. Ekipi hulumtues e zgjodhi këtë qasje duke u nisur nga supozimi që ekzistojnë dallime të caktuara në qëndrimet dhe orientimet e komunitetit serb në Veri të Kosovës dhe të këtij komuniteti në jug të lumit Ibër. Këtë supozim e vërtetuan edhe rezultatet e hulumtimit, me ç'rast u konstatuan dallime të caktuara në disponimin dhe qëndrimin e respondentëve që jetojnë në jug të lumit Ibër, siç do të shihni edhe në analizat në vijim.

Struktura e mostrës

Struktura e mostrës në bazë të gjinisë është 60% meshkuj dhe 40% femra.

Struktura e mostrës në bazë të moshës: 26% të respondentëve janë të moshës 16-25 vjeç, 25% të respondentëve janë të moshës 26-35, 20% të grupmoshës 36-45, 16% të grupmoshës 46-55, 7% të grupmoshës 56-65 dhe 6% të respondentëve më të vjetër se 66 vjeç.

Struktura e mostrës në bazë të shkollimit: 1% të respondentëve nuk kishin vijuar fare shkollën, 4% të respondentëve kishin mbaruar shkollën fillore, 62% me shkollë të mesme, 31% me diplomë universitare dhe 2% me diplomë të magistraturës.

Struktura e mostrës në bazë të statusit shoqëror: 21% të respondentëve janë të punësuar në sektorin shtetëror, 16% në sektorin privat, 22% janë të papunë, 7% janë pensionistë, 23% studentë/nxënës, 4% amvise dhe 7% bujq.

Analizë e qëndrimeve

I. QËNDRIMET RRETH BASHKIMIT EVROPIAN

Niveli i informimit për BE-në (Shih diagramin 3)

Rezultatet e hulumtimit kanë treguar që komuniteti serb nuk është sa duhet i informuar për Bashkimin Evropian. Respondentët në të gjitha regjionet/komunat, përveç atyre në Graçanicë, në masë të madhe deklaruan që nuk janë mjaft të informuar për Bashkimin Evropian.

Në katër zona të hulumtimit, në pyetjen a janë mjaft të informuar për BE-në, dominon përgjigja JO: në **Veri** raporti në mes PO dhe JO është 25 / **30**, në **Ranillug** 18 / **33**, në **Shtërpce** 21 / **38**, në **Rahovec** 28 / **40**; vetëm në Graçanicë dominon përgjigja PO (**41** / 23).

Në **mostrën totale** dominon përgjigja për informimit të pjesshëm, me 41% në raport me 26% të cilët u përgjigjen se janë mjaft të informuar, respektivisht 33% të cilët thonë se nuk janë mjaft të informuar.

Përkatësia ndaj Evropës (Shih diagramin 4)

Kur bëhet fjalë për ndjenjën e përkatësisë ndaj Evropës, është interesante se vetëm në pjesën veriore të Kosovës më shumë respondentë (38%) u deklaruan që ndihen qytetarë të Evropës, në krahasim me 35% të cilët e mohuan këtë.

Në **Graçanicë** përgjigjet në pyetjen për përkatësi ndaj Evropës

janë 26/**50**, në **Ranillug** 39/**44**, në **Shtërpce** 19/**54** dhe në **Rahovec** 21/**63**.

Në **mostrën totale** dominon ndjenja e përkatësisë ndaj Evropës: në përqindjet 30/**49**.

Vlerësimi i zhvillimit lokal evropian (shih diagramin 19)

Qëllimi i anketës ishte të mat perceptimin e respondentëve rreth zhvillimit lokal, më konkretisht deri në çfarë mase zhvillimi lokal përputhet me dimensionet evropiane.

Vlerësimi i përgjithshëm i respondentëve ishte që zhvillimi lokal evropian është i keq ose shumë i keq. Në **mostrën totale** përqindja në mes përgjigjeve *i mirë dhe shumë i mirë*, në një të anë, dhe *i keq dhe shumë i keq* në anën tjetër, në **Veri** 0/**93**, në **Graçanicë** 15/**53**, në **Ranillug** 6/**64**, në **Shtërpce** 20/**39**, dhe në **Rahovec** 8/**68**.

Vlerësimi i kufijve të hapur (shih diagramin 10)

Në anën tjetër, njëra ndër vlerat themelore të Evropës bashkëkohore - kufijtë e hapur – u vlerësua pozitivisht në tërë mostrën: në **mostrën totale** 51% e respondentëve u përgjigjen pozitivisht, ndërsa 24% negativisht.

Në vijim janë përgjigjet PO/JO varësisht nga përqindjet, rajonet/krahinat: në **Veri** 47/16, në **Graçanicë** 45/37, në **Ranillug** 49/32, në **Shtërpce** 48/19 dhe në **Rahovec** 67/14.

A duhet BE-ja ti zgjidh problemet e serbëve në Kosovë? (shih diagramin 9)

Komuniteti serb në Kosovë është mjaft skeptik rreth rolit të Bashkimit Evropian në zgjidhjen e problemeve të tyre. Në pyetjen a duhet BE-ja të ketë rol kyç në zgjidhjen e problemeve të komunitetit serb, në **mostrën totale** 35% janë përgjigjur pozitivisht dhe 39% negativisht.

Qëndrimet dallojnë varësisht nga rajonet/krahinat: përqindja e përgjigjeve PO/JO në **Veri** është 21/**43**, në **Graçanicë** 57/28, në **Ranillug** 24/**45**, në **Shtërpce** 25/**53** dhe në **Rahovec** 48/25.

Investimet e huaja në Kosovë (shih diagramin 20)

Serbët në veri dhe ata në jug të lumit Ibër kanë mendime të ndryshme rreth investimeve të huaja në Kosovë.

Në **Veri** shumica prej 51% mendojnë se në Kosovë ka mjaft investime, ndërsa 23% mendojnë se këto investime janë të pamjaftueshme. Në krahinat e pjesës qendrore dominon qëndrimi se nuk ka investime të mjaftueshme, në **Graçanicë** proporcioni është 22/75, në Ranillug 39/49, në Shtërpce 33/45, në Rahovec 31/61. Në **mostrën totale** poashtu mbizotëron mendimi që nuk ka investime të mjaftueshme në proporcionin 35/51.

Investimet e huaja në Veri (shih diagramin 21)

Mendimi i përgjithshëm në mesin e të intervistuarve nga komuniteti serb në Kosovë është që bashkësia ndërkombëtare nuk investon sa duhet në pjesën veriore të Kosovës. Në **Veri** shumica prej 8% mendojnë se në veri ka investime të mjaftueshme, derisa 75% mendojnë që këto investime nuk janë të mjaftueshme.

Në krahinat në pjesën tjetër të Kosovës poashtu dominon mendimi që në Veri nuk ka investime të mjaftueshme, në **Graçanicë** ky proporcion është 24/**72**, në **Ranillug** 15/**55**, në **Shtërpce** 11/**64**, në **Rahovec** 45/**39**.

Në **mostrën totale** poashtu dominon mendimi që investimet në Veri nuk janë të mjaftueshme në proporcionin 21/**61**.

II. KOSOVA DHE BASHKIMI EVROPIAN

■ Qëndrimet rreth anëtarësimit të Kosovës në BE

(shih diagramin 5)

Dallimi në qëndrimet e të intervistuarve në Veri dhe qëndrimet e të intervistuarve në krahinat e tjera të Kosovës rreth çështjes së përkatësisë ndaj Evropës, bëhet edhe më i madh rreth çështjes së anëtarësimit të mundshëm të Kosovës në Bashkimin Evropian. Në mënyrë paradoksale, **Veriu**, edhe pse me orientime më pro-evropiane, është shumë më homogjen në kundërshtimin e integritit të Kosovës në BE. Këtë e shohim si indikacion të largimit të madh të Veriut nga realiteti kosovar. 73% të të intervistuarve në **Veri** u deklaruan kundër anëtarësimit të Kosovës në BE, në raport me 5% të cilët ishin në favor të anëtarësimit.

Në krahinat në pjesën tjetër të Kosovës dominon qëndrimi kundër integritit të Kosovës në BE, por në proporcione më të balancuara: në **Graçanicë** raporti i përgjigjeve PO/JO është në përqindjet 34/**50**, në **Shtërpce** 29/**42**, në **Rahovec** 34/**42**.

Vetëm në **Ranillug** është më e madhe përqindja e atyre që u deklaruan në përkrahje të anëtarësimit të Kosovës në BE në raportin **48/43**.

■ Potenciali i Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian (shih diagramin 6)

Komuniteti serb në Kosovë është poashtu mjaft skeptik rreth potencialit të Kosovës për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Rreth kësaj teme ekziston pajtueshmëri e plotë: në **Veri** raporti PO/JO përqindja është 0/**68**, në **Graçanicë** 23/**68**, në **Ranillug** 5/**60**, në **Shtërpce** 7/**55**.

Vetëm në **Rahovec**, edhe pse dominon mendimi që Kosova nuk ka potencial për t'u anëtarësuar në BE, qëndrimet janë pothuajse të baraspeshuara në proporcionin 32/**35**.

Edhe në **mostrën totale** dominon mendimi që Kosova nuk ka potencial për t'u anëtarësuar në BE dominon me proporcionin 14/**57**.

Kur pritët integrimi i Kosovës në BE (shih diagramin 7)

Niveli i madh i skepticizmit rreth anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian erdhi në shprehje edhe në përgjigjet në pyetjen kur do të anëtarësohet Kosova në BE.

Në **Veri të Kosovës**, 51% u deklaruan që Kosova kurrë nuk do të anëtarësohet në BE, ndërsa rreth viteve të supozuara 2015, 2020 dhe 2025 nuk ka pasur asnjë parashikim pozitiv. Veriu fare nuk e sheh dhe nuk e dëshiron Kosovën në BE.

Në jug të lumit Ibër, qëndrimet janë më të balancuara: në **Graçanicë** 28% të intervistuarve u deklaruan pozitivisht për anëtarësimin e Kosovës në BE, ndërsa 28% u përgjigjen me Kurrë. Në **Ranillug** 22% dhanë përgjigje pozitive, ndërsa **23%** thanë Kurrë; në **Shtërpce** 19% dhanë përgjigje pozitive, ndërsa **31%** thanë Kurrë; në **Rahovec** 36% dhanë përgjigje pozitive, ndërsa **15%** thanë Kurrë.

Përfitimet e Kosovës nga integrimi në BE (shih diagramin 8)

Komuniteti serb në Kosovë është deri diku i ndarë rreth asaj së sa do të përfitonte Kosova nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian.

Në **Veri** dhe në **Graçanicë** shumica mendojnë që Kosova nuk do të ketë kurrfarë përfitimi nga BE-ja; në përqindjet PO/JO **Veri 6/57**, **Graçanicë 32/51**; ky qëndrimet dominon edhe në **mostrën totale 29/34**.

Në tri krahinat në pjesën tjetër të Kosovës dominon qëndrimi që Kosova do të ketë dobi nga integrimi në BE: në përqindjet PO/JO: **Ranillug 33/26**, **Shtërpce 33/22**, në **Rahovec 41/15**.

Niveli i informimit rreth procesit të integrimit të Kosovës në BE (shih diagramin 11)

Njëra prej arsyeve për nivelin e ulët të përkrahjes për integrimin e Kosovës në BE duhet kërkuar edhe në mungesën relative të informimit të komunitetit serb rreth procesit të anëtarësimit të Kosovës në BE.

Në **mostrën totale** vetëm 16% e të intervistuarve u deklaruan se janë të informuar për këtë çështje.

Në **Veri** niveli i informimit është 0%, në **Graçanicë** 37%, në **Ranillug** 5%, në **Shtërpce** 17%, në **Rahovec** 19%.

III. PËRCEPTIMI I PROBLEMIT TË KOSOVËS

Në çfarë drejtimi po shkon Kosova? (shih diagramin 18)

Perceptimi i përgjithshëm i komunitetit serb është që Kosova po shkon në drejtim të gabuar.

Në **mostrën totale**, 10% e të intervistuarve u përgjigjën që Kosova po shkon në drejtimin e duhur, ndërsa **56%** u deklaruan që Kosova po shkon në drejtim të gabuar. Në **Veri** ky proporcion në përqindje është tejet negativ me 0/**83**, në **Graçanicë** 19/61, në **Shtërpce** 6/49, në **Rahovec** 16/35.

Renditja e problemeve në Kosovë (shih diagramin 12)

Respondentëve iu ofrua një listë me pesë probleme prej të cilëve ata duhej të tregonin cili sipas mendimit të tyre është problemi më i madh në Kosovë.

Në **mostrën totale** me 26% udhëheqin *Gjendja politike* dhe *Kriminaliteti*, pastaj vjen *Gjendja ekonomike* me 23%, pastaj *Korrupsioni* me 14%, dhe në fund të listës së problemeve është *Papunësia* me 9%.

Në vijim është lista e problemeve sipas rajoneve/komunave:

Në **Veri** dominon *kriminaliteti* (39) dhe *korrupsioni* (33), në **Graçanicë** *Gjendja politike* (33) dhe *Kriminaliteti* (27), në **Ranillug** *Gjendja ekonomike* (47) dhe *Kriminaliteti* (32), në **Shtërpce** *Gjendja politike* (26) dhe *Kriminaliteti* (25) dhe në **Rahovec** *Gjendja politike* (46) dhe *Gjendja ekonomike* (34).

Korrupsioni në Kosovë (shih diagramin 16)

Edhe pse në listën e problemeve kryesore, korrupsioni në këtë anketë u rendit si problemi i katërt, në pyetjen e drejtpërdrejt se a është korrupsioni problem i madh apo i vogël, ai u vlerësua kryesisht si problem i madh, në **mostrën totale** nga 70% e të intervistuarve, në **Veri** 89%, në **Graçanicë** 73%, në **Ranillug** 66%, në **Shtërpce** 76% dhe në **Rahovec** 45%.

Marrëdhënia në mes serbëve dhe shqiptarëve

(shih diagramin 13)

Mendimi i përgjithshëm është që marrëdhëniet në mes serbëve dhe shqiptarëve janë kryesisht të *këqija* ose *shumë të këqija*.

Në **mostrën totale**, proporcioni në mes të përgjigjeve të *mira* dhe *shumë të mira*, në njërën anë, dhe të *këqija* dhe *shumë të këqija*, në anën tjetër, në përqindje është 13/55, në **Veri** 1/91, në **Graçanicë** 19/64, në **Ranillug** 9/42, në **Shtërpce** 10/50 dhe në **Rahovec** 24/28.

IV. VLERËSIMI I PUNËS SË QEVERIVE DHE UDHËHEQËSVE

Qeveria lokale (shih diagramin 14)

Vlerësimi i përgjithshëm i punës së qeverisë lokale është kryesisht *i keq* ose *shumë i keq*, posaçërisht në **Veri**, ku 93% e të intervistuarve vlerësojnë punën e qeverisë lokale me notë të keqe (50%) ose shumë të keqe (43%), derisa vetëm 3% e të intervistuarve e vlerësojnë si të *mirë* ose *shumë të mirë* punën e qeverisë lokale!

Në krahinat në pjesën tjetër të Kosovës, vlerësimet janë deri diku të balancuara: në **Graçanicë** proporcioni në mes vlerësimit pozitiv dhe atij negativ është i lartë me 18/65, derisa në tri komunat e tjera dominon vlerësimi pozitiv: në **Ranillug** 35/28, në **Shtërpce** 30/28, dhe në **Rahovec** 34/21.

Në **mostrën totale** megjithatë dominon vlerësimi negativ rreth punës së qeverisë lokale në proporcionin 24/47.

Qeveria qendrore (shih diagramin 15)

Vlerësimi i përgjithshëm për punën e qeverisë qendrore është negativ, posaçërisht në **Veri**, ku 99% e të intervistuarve e vlerësuan punën e qeverisë qendrore si të *keqe* (39%) ose *shumë të keqe* (60%). Nuk kishte asnjë vlerësim pozitiv, dhe vetëm 1% e të intervistuarve u deklaruan që puna e qeverisë qendrore nuk është as e *mirë* as e *keqe*!

Në **Graçanicë** përsëri kemi proporcion të lartë në mes vlerësimit pozitiv dhe negativ për punën e qeverisë qendrore me 18/60, në **Ranillug** dominon vlerësimi negativ 13/41, poashtu edhe në **Shtërpce** 24/37, dhe vetëm në **Rahovec** dominon vlerësimi pozitiv 39/27.

Në **mostrën totale** dominon vlerësimi negativ për punën e qeverisë qendrore në proporcionin 18/54.

Besimi në përfaqësuesit e serbëve në veri dhe në jug të lumit Ibër (shih diagramin 22)

Cilët përfaqësues politik të serbëve - ata në veri apo në jug të lumit Ibër - gëzojnë besim më të madh nga pjesëtarët e komunitetit serb?

Në **mostrën totale**, përfaqësuesit në Veri, gëzojnë dyfish më tepër besim në raport me përfaqësuesit politik në jug të lumit Ibër, në proporcionin **40/21**.

Ky dallim kushtëzohet me përkrahjen e madhe për udhëheqësit në **Veri** në proporcionin **76/3**, si dhe në Graçanicë **22/12**, në **Ranillug 44/27**, në **Rahovec 38/27**, derisa në Shtërpce më shumë përkrahje gëzojnë udhëheqësit nga jugu në proporcionin **19/37**. Një numër i madh i të intervistuarve refuzuan të përgjigjen në këtë pyetje, 21% në **Veri**, 66% në **Graçanicë**, 29% në **Ranillug**, 44% në **Shtërpce**, 35% në **Rahovec** dhe 39% në **mostrën totale**.

Vlerësimi i qëndrimeve të komunitetit serb në Veri (shih diagramin 23)

Në të gjitha lokacionet ku u zhvillua anketimi qëndrimet e komunitetit serb në Veri gëzojnë përkrahje bindëse.

Në **mostrën totale** përkrahja ia kalon refuzimit të përkrahjes në proporcionin **49/14**, në **Veri** ky proporcion është **75/11**, në **Graçanicë 36/3**, në **Ranillug 58/16**, në **Shtërpce 31/17** dhe në **Rahovec 45/20**. Shkalla e refuzimit të përgjigjes në këtë pyetje ka qenë posaçërisht e lartë në **Graçanicë 61%** dhe në **Shtërpce 52%**.

Vlerësimi i qëndrimeve të komunitetit serb në jug të lumit Ibër (shih diagramin 24)

Edhe në këtë pyetje, ishte karakteristike që shumë respondentë nuk pranuan të përgjigjen ose deklaruan që nuk dinë si t'i vlerësojnë qëndrimet e komunitetit serb në jug të lumit Ibër: në **mostrën totale** nuk u përgjigjën 43%, në **Veri** 30%, në **Graçanicë** 60%, në **Shtërpce** 49% dhe në **Rahovec** 30%.

Megjithatë, përveç në Veri ku *përkrahja* është dukshëm më e ulët se *refuzimi i përkrahjes* në proporcionin 19/**51**, në krahinat në jug të lumit Ibër dominon përkrahja ndaj qëndrimeve të komuniteteve lokale. Në **mostrën totale** përkrahja është më e madhe sesa mospërkrahja në proporcionin **31/26**, në **Graçanicë** **33/7**, në **Ranillug** **30/25**, në **Shtërpce** **32/19**, dhe në **Rahovec** **43/27**. Shkalla e refuzimit të përgjigjes në këtë pyetje ishte e lartë në **Graçanicë** 61% dhe në **Shtërpce** 52%.


Pasqyra grafike e rezultateve të anketës me shpjegime

1. Burimet kryesore të informimit

Në pjesën hyrëse të anketës dhe me qëllim të relaksimit të bashkëbiseduesve, dy pyetjet e para kishin të bëjnë me burimet e informimit dhe me besimin e të intervistuarve në mediat.

Burimi kryesor i informimit për komunitetin serb në Kosovë janë Televizioni dhe Interneti, derisa Shtypi dhe Radiot mbesin mjaft prapa posaçërisht në jug të lumit Ibër.

- Në **mostrën totale**, 49% e të intervistuarve deklaruan që si burim kryesor të informimit e kanë televizionin, 5% radion, 15% shtypin dhe 31% internetin.




- Në **Veri të Kosovës**, televizioni është burimi kryesor i informimit me 39%, shtypi është në vend të dytë me 34%, interneti në vend të tretë me 24% dhe radio në vend të katërt me 3%.
- Në **Graçanicë**, televizioni është burimi kryesor i informimit me 79%, interneti është në vend të dytë me 26%, shtypi në vend të tretë me 20% dhe radio në vend të katërt me 1%.
- Në **Ranillug**, televizioni është burimi kryesor i informimit me 60%, interneti është në vend të dytë me 32%, shtypi në vend të tretë me 5% dhe radio në vend të katërt me 3%.
- Në **Shtërpce**, televizioni është burimi kryesor i informimit me 61%, interneti në vend të dytë me 30%, shtypi në vend të tretë me 8% dhe radio në vend të katërt me 1%.
- Në **Rahovec**, televizioni është burimi kryesor i informimit me 42%, pothuajse në vend të njëjtë është interneti me 41%, radio në vend të tretë me 9% dhe shtypi në vend të katërt me 8%.

2. Sa iu besoni medimeve në Kosovë?

Komuniteti serb në Kosovë, sipas kësaj ankete, nuk iu beson shumë medimeve.

- Në **mostrën totale**, vetëm 8% u deklaruan që iu besojnë plotësisht medimeve, 51% iu besojnë pjesërisht, ndërsa 41% u deklaruan që aspak nuk iu besojnë medimeve.
- Në **Veri të Kosovës**, besimi i plotë në mediumet është i barabartë me zero, 34% iu besojnë pjesërisht, ndërsa 66% nuk iu besojnë aspak medimeve.
- Në **Graçanicë**, 7% iu besojnë plotësisht medimeve, 51% iu besojnë pjesërisht, ndërsa 42% nuk iu besojnë aspak.
- Në **Ranillug**, 5% iu besojnë plotësisht medimeve, 65% iu besojnë pjesërisht, 30% nuk iu besojnë aspak.
- Në **Shtërpce**, 5% iu besojnë plotësisht medimeve, 54% iu besojnë pjesërisht, 41% nuk iu besojnë aspak.
- Në **Rahovec**, 21% iu besojnë plotësisht medimeve, 56% iu besojnë pjesërisht, 23% nuk iu besojnë aspak.




3. A jeni mjaft të informuar për Bashkimin Evropian?

Rezultatet e anketës tregojnë që serbët në Kosovë janë kryesisht pak të informuar për Bashkimin Evropian.

- Sipas **mostrës totale**, vetëm 26% mendojnë që kanë *informata të mjaftueshme* për BE-në, 33% u deklaruan që kanë *informata të pjesshme*, dhe 41% u deklaruan që *nuk kanë informata të mjaftueshme* për BE-në.
- Shkalla më e lartë e informimit për BE-në është në **Graçanicë** 41%, dhe më e ulëta në **Ranillug** me 18%.

Kjo është ndër pyetjet e pakta ku ekziston pajtueshmëri relative në mes të respondentëve nga krahinat e ndryshme të banuara me serbë.


Përgjigjet e dhëna në veri të Kosovës janë në korrelacion relativ me ato në krahinat e tjera.



4. A e ndjeni veten qytetar të Evropës?

Rezultatet e anketës tregojnë që diç më pak se një e treta (30%) e serbëve të Kosovës e ndjejnë veten qytetarë të Evropës. 49% e të intervistuarve u përgjigjen se nuk ndihen si qytetarë të Evropës, 17% u përgjigjen me nuk e di, ndërsa 4% nuk u përgjigjen fare.


- Është interesante se të intervistuarit në **veri të Kosovës** mesatarisht më së shumti zgjedhën përgjigjen e parë, që ndihen qytetarë të Evropës (38%) në krahasim me përgjigjen negative (35%).
- Në krahinat në pjesën tjetër të Kosovës, vetëm në **Ranillug** është përqindja më e madhe e atyre që e konsiderojnë veten qytetarë të Evropës (39%).
- Në krahinat në pjesën tjetër të Kosovës është relativisht e lartë përqindja e përgjigjeve negative të respondentëve rreth asaj se a ndihen qytetarë të Evropës, posaçërisht në **Rahovec** me 63%, pastaj në **Shtërpce** me 54%, **Graçanicë** 50% dhe në **Ranillug** 44%.



5. A e përkrahni anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian?

Sa i përket pyetjes rreth integritit të Kosovës në BE, mostra totale e respondentëve dhanë përqindje pothuajse identike të përgjigjeve si në pyetjen paraprake se a ndihen qytetarë të Evropës.


- Në **mostrën totale**, në favor të integritit të Kosovës në BE u deklaruan 30% e të intervistuarve, kundër integritit u deklaruan 50%, 16% u përgjigjen me nuk e di, dhe 4% nuk u përgjigjën fare.
- Dallimi i përgjigjeve sipas krahinave dhe rajoneve dallon në mënyrë dramatike.
- Në **veri të Kosovës** 73% e të intervistuarve u deklaruan kundër integritit të Kosovës në BE, ndërsa vetëm 5% u deklaruan në favor të integritit.
- Në **Graçanicë** 50% e të intervistuarve ishin kundër integritit në BE, 34% në favor të integritit, dhe 14% u përgjigjen me nuk e di.
- Në **Ranillug**, kryeson përgjigja në favor të integritit me 48% në raport me përgjigjen kundër integritit me 43%.
- Në **Shtërpce** 29% janë në favor të integritit, dhe 42% janë kundër.
- Në **Rahovec** 34% përkrahin integritin në BE dhe 42% janë kundër.



6. A mendoni se Kosova ka potencial të mjaftueshëm për t'u integruar në BE?

Respondentët serbë janë shumë skeptik rreth potencialit të Kosovës për tu integruar në Bashkimin Evropian.


- Në **mostrën totale**, vetëm 14% e të intervistuarve mendojnë që Kosova ka potencial për integrim, 57% ofruan përgjigje negative, 25% u përgjigjen me nuk e di, ndërsa 4% nuk u përgjigjen fare.
- Qëndrimet më skeptike i ofruan të intervistuarit në **veri të Kosovës**: 68% mendojnë që Kosova nuk ka potencial, 0% mendojnë që ka dhe 30% u përgjigjen me nuk e di.
- Në **Graçanicë** shumica prej 68% mendojnë që Kosova nuk ka potencial, 23% mendojnë që ka dhe 7% u përgjigjen me nuk e di.
- Në **Ranillug**, 60% mendojnë që Kosova nuk ka potencial për integrim, 5% mendojnë që ka, 34% u përgjigjen me nuk e di.
- Në **Shtërpce**, 55% nuk ka potencial, 7% ka potencial, 28% u përgjigjen me nuk e di.
- Në **Rahovec**, përgjigjet ishin pak a shumë të balancuara, 35% mendojnë që Kosova nuk ka potencial për integrim, 32% mendojnë që ka potencial dhe 30% u përgjigjen me nuk e di.



7. Kur do të anëtarësohet Kosova në Bashkimin Evropian?

Respondentët serbë ishin edhe më tepër skeptik rreth kornizës kohore të integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian.

- Në **mostrën totale** të respondentëve, 8% u përgjigjen se Kosova do të anëtarësohet në vitin 2015, 5% u përgjigjen në 2020, ndërsa 7% në 2025. 30% u përgjigjen se Kosova kurrë nuk do të anëtarësohet ne BE, 46% u përgjigjen me nuk e di, dhe 4% nuk u përgjigjen fare.
- Edhe në këtë pyetje, më skeptikë ishin të intervistuarit nga **veriu i Kosovës**, ku shumica prej 51% u përgjigjen se Kosova kurrë nuk do të anëtarësohet ne BE, dhe asnjë respondent nuk tha se Kosova mund të anëtarësohet në 2015, 2020 apo 2025.
- Në **Graçanicë**, 11% u përgjigjen se Kosova do të anëtarësohet në vitin 2015, 6% në 2020, 11% në 2025, 28% mendojnë se ajo kurrë nuk do të anëtarësohet në BE, 41% u përgjigjen me nuk e di, dhe 3% nuk u përgjigjen fare.




- Në krahinat tjera të banuara me serbë kryesisht dominon skepticizmi rreth kësaj çështje. 23% në **Ranillug** u deklaruan se Kosova kurrë nuk do të anëtarësohet në BE, 31% në **Shtërpce** dhe 15% në **Rahovec**. Përqindje më e madhe mbretëronte në mesin e të intervistuarve që u përgjigjen me nuk e di: **Ranillug** 54%, **Shtërpce** 43%, **Rahovec** 45%.
- Në këto tri krahina në brendi të Kosovës, një përqindje e caktuar e të intervistuarve prej 22% në **Ranillug**, 17% në **Shtërpce** dhe 36% në **Rahovec** ofruan parashikime rreth viteve kur Kosova do të mund të anëtarësohej në BE, me përqindje kryesisht nën 10%, përveç në Rahovec ku 21% mendojnë që Kosova do të anëtarësohet në BE në vitin 2015.

8. A do të përfitoj Kosova nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian?

Në pyetjen se a do të përfitoj Kosova nga anëtarësimi në BE, të paktën dy grupe të respondentëve, në veri të Kosovës dhe në Graçanicë, në mënyrë të pjesshme e demantojnë skepticizmin absolut të shprehur më herët rreth mundësisë së anëtarësimit të Kosovës në BE.

- **Mostra totale** jep përqindjet vijuese: 29% mendojnë që Kosova *do të përfitoj* nga anëtarësimi në BE, 34% mendojnë që *nuk do të përfitoj*, 32% përgjigjen me nuk e di, dhe 5% nuk japin fare përgjigje.
- Në **veri të Kosovës**, vetëm 6% mendojnë që Kosova do të përfitoj nga anëtarësimi, 57% mendojnë që nuk do të përfitoj, 34% përgjigjen me nuk e di, dhe 3% nuk ofruan fare përgjigje.
